

VENDIM
Nr. 554, datë 27.8.2014

PËR NDRYSHIMIN NGA TOKË BUJQËSORE TË KATEGORISË V NË TOKË
URBANE (TRUALL) TË DISA SIPËRFAQEVE NË MBËSHTETJE TË SKEMAVE
QË PËRFITOJNË NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 71, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin nga tokë bujqësore të kategorisë V në tokë urbane (truall) të disa sipërfaqeve, në mbështetje të skemave që përfitojnë nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për:

a) subjektin “2A Manxhari 2011”, zona kadastrale 1773, sipërfaqja 5 100 (pesë mijë e njëqind) m², Fier;

b) subjektin “A&Kristi”, sh.p.k., zona kadastrale 1841, sipërfaqja 2 940 (dy mijë e nëntëqind e dyzet) m², qarku Fier.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokave në Fier, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, si dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

